

Data 23.05.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Regjistrim fillestar i pasurive të paluajtshme ZK 3560 në Tamarë dhe ZK 3815 në Vorfë, Malësi e Madhe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Shërbime rregjistrimi.

VLERA E FONDIT LIMIT:

8 333 333 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tri mijë e treqind e trihjetë e tre) lek pa tvsh dhe 10 000 000 (dhjetë milion) lek me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:
Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimi dhe kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2021- 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nqs dy bilancet e njepasnjeshme nuk kane raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

b) b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021- 2022 - 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres së fondit limit të kontrates që prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet, të kryer/realizuar gjatë tri viteve të nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- *Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me institucione shtetërore (entet publike), duhet te paraqitet Vërtetim për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- *Kur shërbimi i ngjashem është realizuar me sektorin privat, duhet te paraqitet si dëshmi vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*
- *Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose se paku 40% i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjesve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për periudhën e fundit objekt deklarimi, duhet të jetë të paktën 10 (dhjete) punonjes. Kjo do të vërtetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjesve për secilin muaj për periudhën perkatese.

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese të konfirmuar nga Administrata Tatimore (në formë elektronike);

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjesve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si **volumet dhe kategoritë e punimeve**, kualifikimi i punonjesve, **grafiku i punimeve (sipas grafikut të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK)**, **zërat e punimeve dhe orët e punës sipas Kodit të Punës** etj.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i licensuar në fushën e punimeve topografike me license projektimi dhe zbatimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimiti” të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” si dhe pika 4, neni 41 I VKM 285/2021. Kategoritë janë kërkuar bazuar në listen e zërave dhe vlerat e punimeve. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë:

- Jo më pak se 2 GPS në pronësi ose me qira. Nëse është në pronësi të shoqërohet me faturën tatimore të blerjes.
- Minimumi 2 Total Station në pronësi ose me qira. Nëse është në pronësi të shoqërohet me faturën tatimore të blerjes.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te të ketë minimumi:

- 2 DRON profesional, te specializuar per fotogrametri, me kamera dixhitale me rezulicon min.36 megapixel, ne pronesi (te shoqerohet me faturen tatimore te blerjes) ose me qira (te shoqerohet me kontraten perkatese te qirase).

- 1 DRON LIDAR–Sensor Skaner profesional te arrije lexime ne 130 m lartesi, i pershtatshem per eliminimin e vegjetacionit, i pajisur me kamer per texture, min. 20 megapixel, ne pronesi ose me qira. Nese eshte ne (te shoqerohet me faturen tatimore te blerjes) ose me qira (te shoqerohet me kontraten perkatese te qirase).

Dronet duhet te shoqerohen me skeden teknike ku te duken qarte parametrat e kerkuar ne DST

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021. Azhornimi i pronave të një fshati me sipërfaqe të mëdha, kërkon paisjet e duhura dhe cilësore në mënyrë që të përmbushen kriteret profesionale dhe ato kohore. Duke qene se në terren do jene se paku dy grupe, për secilin grup nevojitet një GPS dhe një Total Station për kryerjen e matjeve të sakta. Po ashtu për secilin grup, në mënyrë që matjet dhe materialet të grumbullohen e të përpunohen brenda afateve, nevojitet nga një Dron profesional . **Pas përpunimit të fotove, mund të gjenerohen ortofoto të gjithë zones, e cila ndihmon në përpunimin dhe përpilimin e hartave në zyre.** Duke qene se fluturimet do të kryhen në lartesi mbi 100m (për shkak të sipërfaqes së madhe) , nevojitet kamera profesionale me rezolucion jo më pak se 36 mpx, në mënyrë që në ortofoto të dallohen detaje të ndryshme si gardh, kufinj prone, apo lumenje të cilët mund të jene të paarrtshëm në rrugë tokësore gjatë matjeve.(Produkti i LIDAR)

2.3.6. Operatori ekonomik duhet te të ketë në stafin e tij:

- Te pakten 2 Inxhinierë të certifikuar për përdorim të Droneve, për përpunimin e të dhënave gjeohapsinore. Kjo të deshmohet me certifikate origjinale ose fotokopje të noterizuara, të leshuar nga organizma të akredituar certifikues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021.

Për përpunimin e të dhënave gjeohapsinore dhe sidomos punët fotogrametrike, nevojitet 2 inxhinierë të specializuar mbi përdorimin e Droneve dhe përpunimin e materialeve (fotografike) të përfutuara nga fluturimet. Një inxhinier nevojitet për fotografimet në terren dhe një inxhinier për përdorimin e softwareve specifik për përpunim fotogrametrik.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet te të ketë , gjithashtu, në stafin e tij:

- Te pakten 4 inxhinierë gjeodetë dhe 2 topografë.

- Te pakten 2 juristë.

Për këta të paraqiten kontratat e punës, diplomat dhe CV-te perkatese.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, elektrik dhe hidroteknik etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. **Gjeodetet dhe Topografet janë përgjegjës për grumbullimin e të dhënave në terren dhe përpunimin e informacioneve dhe dixhitalizimin e tyre. Për përmbushjen në kohë të afateve të kontratës nevojiten së paku 2 gupe pune në terren ku secili grup të ketë një topograf dhe një inxhinier gjeodet ; dy inxhinierë të tjerë duhet të përpunojnë materialet në kohë reale.**

Juristët janë përgjegjës për implementimin e njohurive juridike mbi çështjet e pronësisë dhe ligjet në fuqi për pronat

2.3.7. Paisjet sipas pikës 2.3.4 duhet të shoqerohen me certifikate kalibrimi- kolaudimi të 6 muajve të fundit.

Argumentimi: Paisjet duhet të jenë të kalibruara brenda 6 muajve në mënyrë që të sigurohet saktësia e nevojshme gjatë matjeve sipas kushteve të vetë kompanive të prodhimit të instrumenteve të lartpërmendur (bazuar në Direktivën INSPIRE)

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.